

Të nderuar pjesëmarrës,

Një institucion modern i auditimit më të lartë publik, një SAI, do të ishte i mangët dhe i izoluar, pa njohjen e plotë të veprimtarisë së tij nga qytetari dhe mbështetjen prej publikut dhe qytetarëve. Sikurse Abraham Linkoln, babai i demokracisë amerikane është shprehur «*Institucionet tona nuk do të jenë kurrë të tilla (pra publike), nëse nuk krijojnë mundësitë të njihen plotësisht, madje edhe të vizitohen apo preken fizikisht nga qytetari pages taksash*¹»

Në bazë të standardit ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 12, “*Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit- të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve*”, vetëm duke qene teresisht transparent dhe i lexueshem ne veprimtarine e vet nga qytetari, një SAI mund te behet i besueshem. ISSAI 12 thekson se “*SAI-t promovojnë eficiencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike. Një SAI i pavarur, efektiv dhe i besueshëm është një komponent thelbësor në një sistem demokratik, ku përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti janë pjesë e domosdoshme e një demokracie të qëndrueshme*”.

6 vite me pare, Kontrolli i Larte i Shtetit, ne platformen strategjike per zhvillimin e institucionit te 14 dhjetorit 2011, percaktova si Objektiv te Tete” **Permiresimin e transparences ne marredheniet me publikun, nepermjet nje partneriteti te gjere me median dhe me organizatat jo-fitimpruresse qe luftojne korrupsionin**. Ky objektivi sot jo vetem eshte realizuar, por edhe zgjeruar dhe zhvilluar me tej, duke vendosur ne qender te komunikimit dhe transparences marredhenien e drejtperdrejte me qytetarin. Kjo eshte arsyeja qe sot celim Muajin e Hapur per Qytetaret, pas organizimit rreth nje viti me pare te Javes se Hapur.

Transparenca e aktivitetit të KLSH-së është një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe të komunikimit të tij shumë dimensional. Ajo rrit besimin e qytetarëve ndaj institucionit dhe ndihmon në shmangien e ndikimit të interesave personale dhe të konfliktit të interesave në punën e tij.

Komunikimi shumëpermator sot po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm për të nxitur transparencën, veçanërisht në kendveshtrimin e informimit dhe konsultimit me qytetarët, të cilët nëpërmjet aksesit që kanë në informacion, sidomos në rrugë dixhitale, njohin vendim-marrjen e institucionit dhe mund të shprehin pikëpamjet e tyre për çështje me interes për ta.

Qasjen e komunikimit të pandërprerë me qytetaret, KLSH e ka parë në keto gjashtë vjet, kryesisht nepermjet bashkepunimit me shoqerine civile dhe me median, si dhe nepermjet pergjigjeve ndaj letrave te qytetareve.

Perfaqesues te shoqerise civile dhe te mediave jane ftuar te marrin pjese qe ne janar te vitit 2012, kur institucioni zhvilloi analizat vjetore ne nivel te departamenteve te auditimit. Me tej, pjesemarrja e tyre dhe nxitja e institucionit qe ata te behen partnere dhe pjese e diskutimeve dhe analizave, ka qene nje konstante e KLSH.

Kemi zgjeruar sidomos ndjeshëm kanalet e komunikimit me median e shkruar të vendit, gazetave dhe revistave, gjatë periudhës 2012-2017. Qasja e re e institucionit është në përputhje të plotë dhe bazohet në standardet profesionale të auditimit publik suprem ISSAI-t, dhe përkatësisht në

¹ Fjala me përfaqësues të qeverisë lokale në Çikago, 10 dhjetor 1856, <http://www.abrahamlincolnonline.org/lincoln/speeches/quotes.htm>

Deklaratën e Limës (ISSAI 1), e konsideruar si Magna Carta e institucioneve të auditimit publik suprem, si dhe në Standardin ISSAI 20 “*Parimet e Transparencës dhe të Përgjegjshmërisë*”, Parimi i 8-të, mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të Institucioneve Supreme të Auditimit.

KLSH ka rritur gradualisht transparencën e veprimtarisë së tij në media, duke arritur në fund të vitit 2016 që të jete i pranishëm 6.7 herë më shumë me informacione dhe mesazhe në mediane e shkruar, si dhe duke gjashtëfishuar praninë në mediat audiovizive, krahasuar me vitin 2010.

Gjatë vitit 2016, shtypi ka pasqyruar raportet dhe deklaratat e KLSH për shtyp në një numër prej 931 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike. Gazetarët u janë përgjigjur prononcimeve të institucionit, problematikave të dala nga auditimet e ushtruara, si dhe gjetjeve dhe rekomandimeve.

Një nga treguesit kryesorë të transparencës dhe hapjes së institucionit për lexuesin e interesuar shqiptar është kolana e botimeve të KLSH-së, e cila në pesë vite 2012-2016 ka arritur në 67 tituj librash. Për këto vit, institucioni synon të shkojë në 83 tituj.

Botimet KLSH janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve supreme të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit, për t'i mundësuar qytetarëve një akses më të gjerë në veprimtarinë e tyre dhe dije me të thella. Kolana e botimeve, e cila pasurohet nga viti në vit, përfshin libra për manualët dhe standardet e auditimit, për raportet e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe të performancës së institucionit, botime me vlerë historike për njohjen e institucioneve evropiane të auditimit suprem, të historikut të KLSH. Kjo kolane pasqyron çdo kronikë të reformave që ka nisur KLSH, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e KLSH-së dhe duke shtuar njëkohësisht edhe besimin e qytetarëve ndaj punës së institucionit.

Çdo vit dinamika e botimeve KLSH rritet me 10 përqind. Këto botime ruajnë cilësinë, thellësinë e analizës, gjerësinë e informacionit dhe plotësinë e mesazheve të përmbajtura në çdo titull dhe përmbajtje libri. Librat e Kontrollit të Lartë të Shtetit, krahas regjistrimit besnik të përmbajtjes së auditimeve të institucionit, të gjetjeve dhe rekomandimeve të çdo auditimi kryesor, përçojnë drejtimet të progresit të tij, që janë rritja e kontributit për përmirësimin e qeverisjes publike, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe ngritja e kapaciteteve të audituesve të KLSH-së në nivelin e një audituesi modern evropian.

Në kolanën e botimeve të KLSH-së bëjnë pjesë edhe një grup botimesh (shtate tituj deri tani) krejt të veçantë, “*Audituesit e KLSH-së në mediane e shkruar*”, referuar viteve 2013, 2014, 2015, 2016 dhe gjysmës së parë të vitit 2017. Artikujt, analizat dhe editorialet e audituesve të KLSH-së, të botuara në shtypin e shkruar periodik përbëjnë pa dyshim një vlerë të shtuar jo vetëm në kontributin e figurës së audituesit në shoqëri, por edhe një aset të publicistikës shqiptare, në këndvështrimin e problematikave të mprehta, të trajtuara me realizëm dhe shumëllojshmëri faktesh.

Këto botime kontribuojnë jo vetëm në krijimin e një historie dinamike të institucionit me një frymë që i shërben një transparence më të madhe me publikun dhe qytetarin, por synojnë njëkohësisht dhe rritjen e kompetencës profesionale të audituesve të institucionit, nëpërmjet vendosjes në një plan më konkret dhe komunikues të audituesit të KLSH përballë të audituarve. Këto shkrime nuk janë botuar si *qëllim në vetvete* por si mjet për të tërhequr në këtë rrugë dhe nëpunësit e institucioneve të çdo niveli të administratës shtetërore, duke i shërbyer kështu jo

vetëm evidentimit të nëpunësve të përgjegjshëm por dhe kalimit në një fazë tjetër të luftës ndaj korrupsionit, për të kontribuar gjithnjë e më shumë dhe në drejtim të ndryshimit të perceptimit të publikut për nëpunësit shteterorë, por dhe institucionet.

Parimi 7 i ISSAI-t 12 “*Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit- të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve*”, kërkon nje komunikim sa me efektiv me palet e interesit. KLSH e sheh qytetarin, publikun si palen kryesore te interesit. Perceptimi i publikut vazhdon të mbetet një problem serioz që kërkon punë dhe vetëm punë intelektuale, njohje dhe komunikim të vazhdueshëm, duke e shoqëruar me shpalosje të plotë transparence dhe integriteti të vetë nëpunësve të institucioneve, si e vetmja rrugë për të fituar besimin e qytetarit.

Nga ne, kjo konceptohet si një sfidë që realizohet ditë pas dite. Risia e pjesëmarrjes aktive të audituesve të KLSH në median e shkruar ka inkurajuar audituesit në këtë drejtim, ndryshe nga vetëm 6 vite më parë, kur institucioni ishte i mbyllur përsa i përket kontaktit me mediat dhe publikun, si dhe pranisë në media të opinionit të audituesve dhe specialistëve të tij.

Prania e audituesve të KLSH-së në media është tashmë rrjedhë normale e punës për ta, në mënyrë që gjetjet dhe rekomandimet e tyre kryesore të mund t’i shtjellojnë me shkrime dhe analiza në shtypin e përditshëm. Gjate katër viteve, 2013-2016, audituesit e KLSH kanë botuar 396 editoriale, intervista, ese dhe analiza.

KLSH nxjerr çdo tre muaj buletin statistikor, në të cilin përfshihen dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara, masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të dorëzuara në Prokurori, për auditimet e përfunduara në periudhat respektive. Të dhënat e këtyre buletineve shpesh herë kanë shërbyer si burim, bazë apo shtysë për artikuj problematikë në shtyp, si dhe për lajme e informacione të shkurtra apo të zgjeruara televizive.

Si një pjesë e pandarë e komunikimit me qytetarin, Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë viteve 2012-2017 ka trajtuar me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit. Edhe në këto raste, i kemi orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t’i drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre. Gjatë vitit 2016, institucioni ka trajtuar 660 letra dhe ankesa, nga të cilat 318 jashtë kompetencës dhe juridiksionit tonë. Nga 342 ankesa në kompetencë të KLSH, që të gjitha janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje.

Interneti është sot zemra e komunikimit për të gjitha institucionet moderne, duke qenë i prekshëm nga të gjithë dhe shumë eficient. Faqja e internetit “KLSH.org” është dritarja kryesore e komunikimit të institucionit me qytetarët, ngaqë u jep atyre mundësinë që të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacion dhe të informohen shpejt lidhur me çështjet që ju interesojnë.

Në faqen WEB të KLSH-së, qytetarët mund të gjejnë informacione të shumta për aktivitetin e institucionit, veçanërisht për raportet e auditimit të tij. Gjatë vitit 2016, në kuadër të rritjes së transparencës, institucioni ka vendosur vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për 152 auditime, nga 154 të realizuara gjithsej, pra në masën 98.7%. Po punojmë që çdo raport auditimi të publikohet në internet.

Qasja e re e komunikimit dhe e transmetimit të informacionit tek publiku nga KLSH, ka ndryshuar pozitivisht mënyrën e perceptimit të publikut për veprimtarinë audituese dhe më gjerë të institucionit. Kjo ka rritur jo vetëm besueshmërinë e qytetarëve tek puna jonë audituese, por ka shtuar njëkohësisht edhe vetëbesimin e audituesve në punën e tyre. Një qasje e tillë i ka bërë ata të jenë të vëmendshëm ndaj çdo detaji dhe të përgjegjshëm për detyrën e vështirë dhe misionin që kanë marrë përsipër për të informuar qytetarin, publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me përdorimin e aseteve dhe burimeve publike me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet nga pushteti qendror, lokal dhe nga njësi të tjera publike.

Vjet, duke synuar aksesin e plotë dhe të drejtpërdrejtë të qytetarëve në Institucion, si Kontroll i Lartë i Shtetit organizuam Javën e Hapur për Qytetarët, nga datat 28 Tetor-04 Nëntor 2016.

Sot, me qëllim njohjen më të plotë dhe të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së Institucionit nga qytetari dhe publiku, si edhe në kuadër të transparencës dhe njohjes së ndërsjellë të punës mes Departamenteve të auditimit në institucion, po çelim Muajin e Hapur për Qytetarët, i cili do të vazhdojë deri më 11 Dhjetor 2017.

Duke vlerësuar misionin tonë si agjent i qytetarit, publikut dhe i Kuvendit, për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të burimeve dhe aseteve publike, synojmë forcimin e besimit të qytetarit dhe publikut në tërësi, nëpërmjet njohjes më nga afër të veprimtarisë sonë, auditimeve dhe rezultateve të auditimeve, si dhe partneritetet që institucioni ka krijuar brenda dhe jashtë vendit, për të përmirësuar qeverisjen publike, duke u përpjekur të luftojmë në thellësi korrupsionin.

Muaji i Hapur do të na shërbejë edhe ne, audituesve të KLSH-së, për të qenë më të hapur dhe komunikues me njeri-tjetrin. Sidomos në nivel të komunikimit dhe të shkëmbimit të eksperiencave mes departamenteve të auditimit, kemi vënë re se jemi deficietarë. Muaji i Hapur do të inkurajojë shkëmbimin e eksperiencave edhe mes audituesve me përvojë, me ata të rinj, në bashkëbisedime dhe konsultime të plota mes tyre. Ai do të ndihmojë edhe komunikimin mes ekipeve të ndryshme të auditimit brenda të njëjtit departament.

Gjatë këtij Muaji, qytetarët që do të vizitojnë mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të njihen me historikun dhe arritjet e institucionit në 92 vitet e ekzistencës së tij, nëpërmjet minizuzeut në koridorin qendror të KLSH, do të takohen me punonjës, auditues dhe ekspertë të ndryshëm të institucionit, për të marrë të gjithë informacionin që ata do të dëshirojnë të kenë, përfshirë edhe auditimet në proces. Këto takime do të shërbejnë jo vetëm për njohjen nga afër të institucionit dhe punonjësve të tij, por edhe për marrje dhe tërheqje mendimesh dhe sugjerimesh me vlerë drejtpërdrejtë nga qytetarët, për auditimet e ardhshme dhe për të përmirësuar punën tonë audituese.

Ky Muaj i Hapur do të jetë dritare komunikimi intensiv, takimesh dhe aktiviteteve, por në realitet, i gjithë institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit është prej gjashtë vitesh tashmë tërësisht i hapur me qytetarin, në kërkim të kontaktit dhe mendimit të tij, për realizimin sa më të plotë të misionit kushtetues të ruajtjes dhe mbikqyrjes së përdorimit me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet të parave të taksapaguesit shqiptar.

Ju faleminderit!